

DEGA GJIMNAZ

Fiskulture dhe Sporte 10, 11, 12

Edukim Fizik 10

-Programi i "Edukimit fizik, sporteve dhe shëndetit" ka si qëllim të shihet si një mjet ideal për promovimin e veprimtarisë së rregullt fizike, edukimin e një stili jetese të shëndetshëm e aktiv dhe fitimin e kompetencave të rëndësishme e të vlefshme për gjatë gjithë jetës, kryerjen e kombinacione lëvizore me përmbajte të aftësive lëvizore bazë, të manipulimit lëvizor me dhe pa mjete, ekzekutimin e teknikave të duhura të vrapimeve dhe kërcimeve, ekzekutimin e teknikave të elementëve kryesore teknikë e taktikë të lojërave.

Edukim Fizik 11

-Programi i "Edukimit fizik, sporteve dhe shëndetit" ka qëllim promovimin e veprimtarisë së rregullt fizike, edukimin e një stili jetese të shëndetshme dhe aktive, kontributin e veprimtarisë fizike në arritjen e gjendjes së fitnesit, njohjen dhe aplikimin në praktikë të mënyrave të thjeshta të dhënies së ndihmës së parë në raste të traumave që ndodhin gjatë veprimtarisë fizike, njohjen me mënyra të parandalimit të tyre, njohjen me rrezikun që vjen si pasojë e përdorimit të lëndëve narkotike dhe efektin e tyre në performancën sportive, hartimin dhe vënien në praktikë të një plani individual pune dhe ushqimi në funksion të përmirësimit të gjendjes fizike, si dhe fitimin e kompetencave të rëndësishme e të vlefshme për gjatë gjithë jetës.

Edukim Fizik 12

-Programi "Edukim fizik, sporte dhe shëndet" ka si qëllim edukimin e një stili jetese të shëndetshëm e aktiv dhe fitimin e kompetencave të rëndësishme e të vlefshme për gjatë gjithë jetës. Ai synon ekzekutimin e teknikave të duhura të elementeve të thjeshta akrobatik dhe të gjimnastikës ritmike e aerobike, stimulimin e aftësive krijuese, përmirësimin e kapaciteteve fizike nëpërmjet kryerjes së vrapimeve të distancave të ndryshme atletikore, si dhe përmirësimin e teknikave. Synon, ekzekutimin e saktë të teknikave të llojeve të ndryshme të kërcimeve dhe hedhjeve, aplikimi i saktë i teknikave të veprimeve lëvizore të mësuara në lojërat lëvizore e tradicionale, si dhe njohjen dhe reflektimin mbi aspektin edukativ të tyre, ekzekutimin e teknikave të elementëve kryesore teknik e taktik të lojërave: basketboll, volejball, hendboll dhe futboll.

Anglisht 10, 11, 12, 13

Anglisht 10

Metoda e përdorur është "Pioneer"- botim i grupit MM Publications, në nivelin A2 Pre-Intermediate sipas Kornizës së Përbashkët Europiane të Referencës së Gjuhëve, njohur ndryshe si CEFR. Ky nivel ka për qëllim të konsolidojë dijet e marra në shkollën 9-vjeçare duke e vendosur nxënësin në një platformë dhe këndvështrim të ri për angazhimin e tërësishëm të tij në planin intelektual dhe emocional për ta vënë atë në shërbim të ambicjeve të tij në përvetësimin e kësaj gjuhe si dhe në funksion të dijeve në lëndë të tjera që mësohen në këtë shkollë. Nxënësi konsolidon në këtë stad reflekset gjuhësore në aftesite baze lexim, shkrim, dëgjim dhe stimulohet në të folur.

Anglisht 11

Metoda është "Pioneer"- botim i grupit MM Publications, në nivelin B1 Intermediate sipas Kornizës së Përbashkët Europiane të Referencës së Gjuhëve, njohur ndryshe si CEFR. Puna është konceptuar si vazhdim i praktikës së nisur në vitin e mëparshëm. Ky kurs synon në një balancim e përfshirje të natyrshme në mësimin e një gjuhe të re mbi një këndvështrim analitik ku nxënësi nxitet të verë re më shumë aspekte komplekse të gjuhës. Nxënësi në këtë fazë kupton një tekst kompleks qartë, komunikon mbi të dhe di gjithashtu të ndërtojë një tekst mbi një spektër të caktuar problemesh. Ai bëhet dëgjues i mirë dhe në përfundim të vitit shkollor është i gatshëm të përballojë kërkesat e nivelit standart B-2 të CEFR (Common European Frame of References).

Anglisht 12

Ky grup nxënësish në këtë vit akademik (2018- 2019) është grupi përmbyllës i ciklit të plotë të metodës "New Inside Out" New edition. Fokusi vendoset në punën me nivelin Advanced të këtij cikli. Nxënësi këtu rishikon në mënyrë harmonike e praktike tërë elementët e kompleksit gjuhësor dhe është i gatshëm të krijojë e interpretojë koncepte nga pikëpamja formale. Nxënësi ndjen tashmë kënaqësinë e tërë punës së kryer duke i mëshuar më shumë punës individuale dhe konsultave gjuhësore qofshin ato brenda apo jashtë orës së mësimin në takimet e hapura të klubit të Anglishtes. Nxënësi është tashmë i gatshëm të përballë me kërkesat bazë në provimet TOEFL apo IELTS për të vazhduar studimet e mëtejshme në universitetet jashtë vendit.

Anglisht 13

Specifika kurrikulare e shkollës tonë krijon dhe dhuron mundësinë për zhvillim më të avancuar gjuhësor në drejtim të komunikimit publik me shkrim dhe me gojë. Nxënësi perfeksionohet në teknikat e korespondencës me letrat zyrtare, ai futet dhe zhvillon bazat e teknikave të shkruarit duke konsoliduar elementë të tillë si shkrimi i artikujve, raporteve, eseve të llojeve të ndryshme si dhe stërvitet të përballojë nivelet më të mira të folurit publik para audiencave të gjera. Standarti i punës në këtë fushë është ai i vendosur nga British Council. Në përfundim të këtij cikli, nxënësi përballon në nivel të lartë kërkesat universitare mbi njohjen e gjuhës angleze brenda dhe jashtë vendit dhe teknikat e komunikimit formal të saj.

Gjuhe e huaj e dyte (Gjermanisht)

Lënda “Gjuhë e huaj e dytë” (gjermanisht) synon zhvillimin gjuhësor dhe letrar, i cili është boshti themelor për rritjen intelektuale, sociale dhe emocionale të nxënësit. Më konkretisht, lënda ‘Gjuhë e huaj e dytë’ e aftëson nxënësin në përdorimin e gjuhës për të komunikuar, për të përmbushur interesat e tij personale dhe shoqërore, si dhe për të plotësuar kërkesat e shoqërisë dhe të botës së punës. Mësimi i gjuhës amtare, i letërsisë dhe i gjuhëve të huaja e ndihmon nxënësin të bëhen individ i pavarur, i lirë, i kulturuar, mendimtar kritik dhe krijues, si dhe i vetëdijshëm për identitetin e tij personal dhe kombëtar. Me anë të leximit të teksteve të letërsisë shqipe dhe asaj botërore (në gjuhën shqipe ose në një gjuhë të huaj), nxënësi zhvillon botën e tij emocionale, pasuron përfytyrimet dhe imagjinatën e tij për botën, çmon dhe vlerëson gjuhët dhe kulturën kombëtare e botërore.

Gjuhe Shqipe 10,11,12:

Gjuha shqipe 10

Synimet themelore të mësimi në klasën e dhjetë janë: përvetësimi i dijeve, formimi gjuhësor, formimi kulturor, formimi si individ dhe si qytetar. Si synime të lidhura drejtpërdrejt me shkollën e mesme të lartë, do të veçojmë zotërimin e gjuhës amtare dhe përvetësimin e kulturës. Synon realizimin e kompetencave që lidhen me të lexuarit e teksteve të ndryshme, të folurit për të komunikuar e mësuar, të shkruarit për qëllime personale e funksionale, të dëgjuarit që realizohen përmes përvetësimit praktik e teorik të njohurive të lëndës. Synim i kësaj lënde është integrimi konceptual i njohurive ndërthurur me lëndë të tjera si histori, art e politikë. Ajo favorizon formimin e nxënësve si individë përmes aftësimit të tyre në përdorimin e gjuhës amtare, përmes mundësive që u jep nxënësve të strukturojnë gjithnjë e më mirë mendimet, gjykimet dhe imagjinatën e tyre. Si rezultat i punës së bërë në këtë nivel shkollimi, nxënësit arrijnë të organizojnë mendimet e tyre dhe të bëjnë me gojë dhe me shkrim paraqitje që

i trajtojnë problemet e trajtuara nga disa pikëpamje. Përmes njohurive që u ofron nxënësve nga trashëgimia kulturore kombëtare dhe botërore dhe përmes analizës së ideve dhe argumenteve përkatëse ajo kontribuon në formimin e tyre si qytetarë.

Gjuha shqipe 11

Lënda e Gjuhës shqipe për klasën e 11 synon të përcjellë përmes larmisë së teksteve, reflektimin e botës ku jetojmë, për të formuar nxënës që zotërojnë kompetencat kyçe të përcaktuara në kornizën kurrikulare: kompetencën e të shprehurit e të komunikimit, e të menduarit, të dëgjuarit, të shkruarit, përvetësimit të rregullave gramatikore, drejtshkrimore e të pikësimit. Kjo lëndë integron temat ndërkurrikulare si: identiteti kombëtar dhe njohja e kulturave, të drejtat e njeriut, vendimmarrja morale dhe nashkëjetesa paqësore duke sjellë tekste ilustruese përkatëse. Në mënyrë të drejtpërdrejtë ndërthuret me fusha e lëndë të tjera si: letërsia, historia, gjeografia, fizika, biologjia, artet, TIK-u etj. Synon të thellojë e sistemojë njohuritë e marra në klasat e mëparshme.

Gjuha 12

Kërkesat themelore për këtë klasë kanë të bëjnë me formimin e mëtejshëm kulturor, letrar e gjuhësor, me përvetësimin e dijeve dhe formimin e personalitetit, duke përfshirë këtu edhe kulturën e sjelljes dhe të komunikimit. Në këtë klasë duhet të zotërohen njohuritë gramatikore të fituara në klasat e mëparshme, të mënjanohen dobësitë morfosintaksore dhe drejtshkrimore, që pengojnë përdorimin korrekt të gjuhës, të detajeve dhe të strukturave më të përgjithshme e komplekse, duke filluar nga fjalia e deri te teksti. Duhet të njihen dhe të përforcohen lidhjet ndërmjet gramatikës, analizës së teksteve, praktikave gojore dhe punëve me shkrim të tipave të ndryshëm; të përforcohen njohuritë për njësitë themelore të gjuhës dhe lidhjet e tyre, nga fonema te fjala, nga fjala te fjalia, nga fjalia e thjeshtë te fjalia e përbërë - ndryshe nga ç'janë zhvilluar në shkollën e mesme të ulët. Po kështu, duhet të zhvillohet edhe puna me drejtshkrimin. Të gjitha këto do të ndikojnë drejtpërdrejt në formimin e mirëfilltë kulturor, letrar e gjuhësor të nxënësit. Rritja e shkallës së zotërimit të gjuhës amtare dhe formimi letrar e kulturor i nxënësit, janë ndër synimet themelore për këtë klasë. Kjo pritet të realizohet nëpërmjet shkathtësive të komunikimit, leximit, analizës e vlerësimit të llojeve të ndryshme të teksteve, letrare e joletrare.

Letersi 10, 11, 12

Letërsia 10

Kjo lëndë është hartuar në përputhje me programin përkatës për studimin letërsisë në klasën e 10. Këtu përmbledhen e sistemohen njohuritë nga Teoria e Letërsisë, të cilat nxënësi i ka studiuar të veçuara në mënyrë praktike deri në klasën e 9. Në këtë nivel nxënësi studion zhvillime të letërsisë shqiptare e botërore, periudha të ndryshme letrare sipas kriterit kronologjik dhe zhvillimit të formave letrare. Gjatë studimit lëndor është mbajtur parasysh që programi i letërsisë të shkojë paralel me atë të lëndës së Gjuhës shqipe. Tekste letrare integrohen e plotësohen me tekste të tjera e me arte të tjera si muzikë, pikturë, skulpturë, film, fotografi etj. Kërkesa të larmishme didaktike synojnë të realizojnë të gjitha kompetencat që kërkohen në programin e lëndës. Është vazhdim i njohurive të marra në ciklin 9- vjeçar. Ky bagazh njohurish sistemohet e ngrihet në nivel më të lartë shkencor. Me këtë informacion të përpunuar didaktik synojmë të formojmë të nxënësi vlera estetike, shpirtërore të kulturës botërore e veçanërisht vlera të kulturës sonë kombëtare.

Letërsia 11

Zhvillimi e kësaj lënde mbi bazën e programit të Letërsisë 11. Synimi i arsimit për kultivimin e identitetit kombëtar dhe personal është pjesë përbërëse e kësaj lënde. "Letërsia 11" realizon marrjen e njohurive të plota, fitimin e shkathtësive, qëndrimeve dhe vlerave për nxënësin. Mbështetet në njohuritë e klasave paraardhëse. Bazohet mbi specifikat e programit, mundëson zotërimin e kompetencave bazë të analizës dhe vlerësimit si dhe zhvillimin e mëtejshëm të kompetencave lëndore qytetare, digjitale, personale, të të menduarit, të të nxënimit, të komunikimit etj. Studimi i lëndës zhvillon shprehitë e të menduarit analizues e vlerësues duke i lënë hapësirë të mendimit të pavarur e krijues të nxënësit. Lidhja me lëndët e tjera dhe temat ndërkurrikulare synon të realizojë njohjen e kulturave të reja, të kultivojë bashkëjetesën duke u dhënë rëndësinë e duhur të drejtave të njeriut. Letërsia 11 është hartuar me synimin që, në përfundim të saj, nxënësi të ndiejë misionin e vërtetë të letërsisë e të shkollës.

Letërsia 12

Zhvillimi i kësaj lënde mbështetet në kompetencat kyçe të përcaktuara në kornizën kurrikulare dhe mundëson realizimin e dy kompetencave të lëndës: analizën dhe interpretimin e teksteve të gjinive dhe llojeve të ndryshme letrare; vlerësimin e letërsisë shqipe dhe botërore në periudha të ndryshme letrare e historike. Këto kompetenca që përcaktohen si njohuri, shkathtësi, vlera dhe qëndrime që nxënësi duhet t'i fitojë gjatë procesit mësimor, mundësojnë krijimin e një raporti pozitiv dhe të qëndrueshëm mes nxënësve dhe lëndës së letërsisë, ndikojnë në

formimin estetik, letrar, në zhvillimin emocional, intelektual e shoqëror, në rritjen e aftësive krijuese dhe në pasurimin e aftësive shprehëse të tyre. Integrohet si lëndë me fushat, artet e temat e tjera ndërkurrikulare përmes situatave, diskutimeve, eseve etj. Kjo lëndë ofron përmbajtje tërheqëse, bashkëvepruese, veprimtari krijuese, që synojnë ngritjen shkencore e intelektuale të nxënësve, zhvillimin e mendimit kritik, zhvillimin gjuhësor, moral, estetik, filozofik, sociologjik e më gjerë.

MATEMATIKE 10, 11, 12:

Matematike 10

Në vitin e parë nxënësit do të marrin njohuri rreth temave të mëposhtme:

Veprimet me numra, Raporti dhe Përpjesëtimet, Matjet dhe saktësia në matje, Këndet dhe shumëkëndëshat, Gjeometri në plan, Rrethi dhe vendet gjeometrike, Shprehjet algjebrike,

Formulat dhe funksionet, Ekuacionet dhe inekuacionet, Përpunimi i të dhënave dhe Probabiliteti.

Matematike 11

Në vitin e dytë nxënësit do të marrin njohuri rreth temave të mëposhtme:

Faktorët, fuqitë dhe rrënjët, Veprimet me numra, Përpjesëtimet, Trigonometria dhe vektorët, Njësitë, Gjeometria në hapësirë, Teorema e Pitagorës, Grafikët (ekuacioni i drejtëzës, koeficienti këndor, funksione lineare, funksioni i fuqisë së dytë, veti të funksionit të fuqisë së dytë, grafikët e lëvizjes largesë -kohë, funksionet e fuqisë së tretë dhe funksioni përpjesëtimor i zhdrejtë, funksionet eksponenciale dhe funksionet trigonometrike, grafikë nga jeta reale, koeficienti këndor, syprina të kufizuara nga grafikë, ekuacioni i rrethit), Vargjet, Normat e ndryshimit, Përpunimi i të dhënave, Probabiliteti i ngjarjeve të kombinuara.

Matematike 12

Në vitin e tretë nxënësit do të marrin njohuri rreth temave të mëposhtme: Fuqitë dhe rrënjët, Logaritmet, Trigonometria (sinusi, kosinusi dhe tangenti, teoremat e sinusit dhe të kosinuit, në Avancë: radiani, funksione të tjera trigonometrike dhe funksionet e anasjella të funksioneve trigonometrike, formulat trigonometrike të shumës dhe diferencës së këndeve), Vektorët (përkufizime dhe veti, koordinatat e vektorit, në Avancë: Vektorët në hapësirë,

prodhimi numerik i vektorëve), Aljebra (argumentimi dhe vërtetimi, funksioni i fuqisë së dytë, sistemet e ekuacioneve, drejtëzat dhe rrahët, inekuacionet, në Avancë: funksionet, ekuacionet parametrike, thyesat algjebrike, zbrëthimi i thyesave algjebrike në thyesa elementare përafrimi i vijave, vargjet, progresionet aritmtike, progresionet gjeometrike), Polinomet dhe teorema binomial, Derivimi dhe integrimi (përkufizimi i derivatit, derivati i $y = ax^n$ dhe simbolika e Lajbnic-it, shpejtësia e ndryshimit, tangjentja dhe pingulja, ekstremumet, integrimi, syprina nën një vijë, në Avancë: përkulshmëria e vijës dhe pikat e infleksionit, funksionet trigonometrike, funksionet eksponenciale dhe logaritmike, rregullat e derivimit të prodhimit dhe të raportit të funksioneve, derivimi i funksionit të përbërë), Funksionet eksponenciale dhe funksionet logaritmike, Mbledhja, paraqitja dhe interpretimi i të dhënave, Probabiliteti dhe ndryshoret diskrete të rastit (probabiliteti, shpërndarja e probabiliteteve, në Avancë: probabiliteti me kusht, shpërndarja binomiale, modelimi me anë të probabilitetit).

Kimi e përgjithshme 10,11,12

Kimi 10

Linja: Struktura dhe vetitë e lëndës. Përmes kësaj linje të gjithë nxënësit fitojnë njohuri, aftësi, qëndrime: për strukturën e atomit; molecules, substancave me ndërtim jonik, kovalent, periodicitet, metalet, jometalet, acidet, bazat, duke përdorur faktet, modelet dhe eksperimentet. Linja: Reaksioni kimik. Përmes kësaj linje, të gjithë nxënësit fitojnë njohuri, aftësi, qëndrime për shpejtësinë e reaksioneve kimike dhe faktorët që ndikojnë në të, si dhe për reaksionet e prapësueshme dhe ekuilibrin kimik e faktorët e tij.

Kimi 11

Linja: Reaksionet Kimike. Përmes kësaj linje, të gjithë nxënësit fitojnë njohuri, aftësi, qëndrime për reaksionet kimike redoks dhe aplikimet e tyre në elektrokimi, jetën e përditshme, si dhe për reaksionet karakteristike të përbërjeve organike si: reaksionet e shtimit, të eliminimit, zëvendësimit radikal, zëvendësimit elektrofilik, zëvendësimit nukleofilik. Linja: Struktura dhe vetitë e lëndës. Përmes kësaj linje, të gjithë nxënësit fitojnë njohuri, aftësi, qëndrime për lidhjet kimike, hibridizimin, forcat ndërmolekulare, strukturën e përbërjeve organike, hidrokarburet, alkoolët, ketonet, aldehidet, acidet karboksilike, aminat, aminoacidet, polimeret, karbohidratet, yndyrnat, proteinat, duke përdorur faktet, modelet dhe eksperimentet.

Fizika 10 dhe 11

Fizika 10

Fizika 10 integron njohuri, shkathtësi, qëndrime e vlera në pjesët: forca dhe lëvizja, elektriciteti dhe valët. Në këtë shkallë, nxënësit zgjerojnë fushën e njohjes për dukuritë më të zakonshme në jetën dhe veprimtaritë e përditshme, zhvillojnë aftësitë, strategjitë dhe shprehitë e të menduarit të nevojshme për hetimin shkencor dhe skicimin teknologjik. Ata lidhin njohuritë shkencore dhe teknologjike me njëra-tjetrën dhe me jetën, përdorin gjuhën dhe terminologjinë shkencore, si dhe krijojnë bazat konceptuale për të nxënësit e mëtejshëm të shkencës.

Fizika 11

Përmes kësaj fushe nxënësit: zhvillojnë njohuritë dhe konceptet bazë për formimin shkencor në fushën e shkencave të natyrës; zhvillojnë aftësitë shkencore, mendimin kritik dhe krijues; zbatojnë njohuritë dhe aftësitë shkencore në mënyrë analitike, kritike dhe krijuese në pjesët e fizikës: energjia mekanike, nxehtësia dhe mënyrat e tejçimit të saj, termodinamika, elektromagnetizmi, fizika bërthamore

Fizikë 12 me zgjedhje

Përmes lëndës fizikë me zgjedhje nxënësit: thellojnë njohuritë dhe konceptet bazë për formimin shkencor në lëndën fizikë, me synim përgatitjen e tyre për të vazhduar studimet në degët e Fakultetit të Shkencave Natyrore, Inxhinierike dhe Mjekësore; zhvillojnë aftësitë shkencore, mendimin kritik dhe krijues; zbatojnë njohuritë dhe aftësitë shkencore në mënyrë analitike, kritike dhe krijuese në problemet që kërkojnë zgjidhje dhe marrje vendimesh; përshkruajnë proceset natyrore në kohë dhe hapësirë; burimet energjetike; shpjegojnë proceset përmes katër bashkëveprimeve (gravitacionale, elektromagnetike, bërthamore dhe të dobëta); përdorin teknologjinë e informacionit dhe të komunikimit, si mjet për sigurimin dhe komunikimin e informacionit;

Biologji 10,11

Lënda e biologjisë, pjesë e kurrikulës së AML-së, zhvillohet në kuadër të formimit të përgjithshëm që nxënësit marrin në fushën e Shkencave Natyrore së bashku me lëndët fizikë dhe kimi.

Kjo lëndë, përmes tërësisë së koncepteve, aftësive e shprehive që krijon, mundëson zotërimin e kompetencave kyçe dhe kompetencave të lëndës së biologjisë.

Të tria kompetencat (Identifikimi dhe zgjidhja e problemeve në biologji; Përdorimi i mjeteve, objekteve dhe procedurave shkencore në biologji; Komunikimi i ideve biologjike duke përdorur gjuhën dhe terminologjinë e shkencës) janë të lidhura ngushtë mes tyre dhe zhvillohen praktikisht në programin e biologjisë nëpërmjet tematikave të mëposhtme:

Diversiteti: Biologjia qelizore; Ndryshueshmëria dhe evolucioni; Trashëgimia; Bioteknologjia; Biodiversiteti; Biokimia.

Sistemet: Ndërtimi dhe funksionimi i sistemeve të kafshët (njeriu) dhe bimët; Transporti të bimët dhe gjitarët; Frymëkëmbimi; Imuniteti; Koordinimi dhe kontrolli; Homeostaza.

Ciklet: Mitoza; Mejoza; Fotosinteza; Frymëmarrja; Fotosinteza; Frymëmarrja; **Ndërveprimi dhe energjia:** Ekosistemet.

Shkencë Toke 10

Shkenca e Tokës synon në njohjen dhe kuptimin e strukturës së Tokës, dinamikës dhe sistemeve gjeofizike të saj, marrëdhëniet ndërmjet sistemeve, marrëdhëniet e Tokës me pjesën tjetër të universit si dhe ndërveprimin me aktivitetin njerëzor. Shkenca e Tokës 10 zhvillon shpjegimet e dukurive themelore të gjeografisë fizike dhe gjeologjisë, përfshirë historinë e Tokës, tektonikën e pllakave, evolucionin e formave të tokës, të dhënat gjeologjike të Tokës, motin dhe klimën, si dhe një bazë njohje astronomike në funksion të kuptimit të dinamikës së Tokës.

Qytetari I/ Filozofi II/ Sociologji 11,12

Vizioni i këtij libri na çon në trajtimin e një aspekti tjetër të dhënies së mësimit: Në daljen në skenë të dimensionit të qytetarisë, nëpërmjet nismave të reja që manifestojnë praninë e një farë rritjeje të vetëdijes.

E thënë ndryshe: mbështetja në idenë se thelbi i qytetarisë qëndron në shpirtin kritik. Por, të kritikosh pa njohje nuk ke bërë asgjë, sepse s'ka asgjë për të kritikuar.

Prandaj në fillim duhet të njohim, e pastaj të kuptojmë që nxënësve u duhet të mësojnë se si të diskutojnë me njëri-tjetrin, të dëgjojnë njëri-tjetrin, të analizojnë dhe të kritikojnë idetë e tyre dhe të atyre që kanë pranë.

Shpesh filozofia shihet e trajtohet si diçka e vështirë, e kotë, e lodhshme dhe e padobishme. Ky tekst synon t'i tregojë nxënësit se asnjë nga këto paragjykime nuk i shkon për shtat filozofisë. Ai duhet ta lexojë me ëndje, (ndaj dhe tekstet janë të shkurtra) ta kuptojë pa vështirësi (ndaj dhe gjuha është e thjeshtë) ta vlerësojë si një shprehje të lirisë së mendimit (ndaj ka argumentin për të debatuar) Sot filozofia dhe të menduarit në mënyrë filozofike konsiderohen si elemente të rëndësishme të ndërtimit të urave lidhëse mes njerëzve, mes qytetërimeve e kulturave të ndryshme. Zemra e misionit të kësaj strategjie është "Filozofia si shkolla e lirisë"! Pse është quajtur e tillë? Sepse të menduarit në mënyrë filozofike u zhvillon njerëzve aftësitë intelektuale për të analizuar situata, për të kuptuar koncepte kyçe të tilla si drejtësi, dinjitet dhe liri. Filozofia kontribuon në një mënyrë të re të menduarit e cila "shtyn", "largon" paragjykimet si sociale ashtu dhe fetare duke kontribuar kështu në paqen sociale e botërore. Duke nxitur debatin e duke pranuar argumentin sigurohet toleranca dhe mirëkuptimi aq të nevojshme për kohën ku jetojmë.

Histori 10,11,12:

Histori 10

Historia 10 synon analizen e qytetërimeve antike greke Romake të Vendeve të Lindjes si dhe qytetërimeve botërore në Mesjetë, si dhe fillimet e Historisë Moderne deri në qytetërimet bashkëkohore.

Ky program shpjegon dhe analizon fakte të ndodhura në këto qytetërimë si dhe qartëson kohën e ndryshimeve thelbësore dhe periudhën e tronditjeve të mëdha me luftrat botërore.

Histori 11

Histori 11 synon analizën e veçantë si dhe përcakton qartë ngjarjet kryesore të historisë botërore nga Antikiteti, Mesjeta, Rilindja Europiane e deri në ditët tona. Ky program shpjegon me fakte të gjitha ndryshimet që kanë ndodhur në fushën politike, ekonomiko-shoqërore apo në fusha të tjera në periudha të ndryshme historike, në rajone dhe vende të ndryshme, si dhe duke identifikuar veçoritë specifike të zhvillimeve historike botërore. Brenda kësaj lende programi ka përfshirë edhe ngjarjet që kanë ndodhur paralelisht edhe në Shqipëri.

Histori 12 (me zgjedhje)

Historia 12 synon të japë një tablo e plotë e historisë kombëtare të shqiptarëve në trojet e tyre etnike në diasporë për të gjitha periudhat nga lashtësia (Antikiteti) e deri në ditët tona e integruar me historinë botërore. Lënda përfshin njohuri nga bota Ilire, Mbretëritë e para si dhe Shtetet e para ilire dhe të dhëna për popullsinë ilire; shqiptarët gjatë periudhës së Perandorisë Bizantine; Epoka e Mesjetës e mishëruar qarte nga Epoka e Skënderbeut; Periudha e pushtimit osman; Rilindja Kombëtare; Periudha e Pavarësisë, Lufta e 1 dhe e 2 Botërore dhe të dhëna për historinë e shqiptarëve jashtë kufijve si dhe të trevave shqiptare nga antikiteti deri në ditët tona (2010)

Gjeografi 11

Gjeografia 11 ose ndryshe Gjeografia Rajonale synon njohjen mbi kompleksitetin natyror e human të rajoneve e nënrajoneve të ndryshme të botës. Gjeografia Rajonale zhvillon aftësitë për të gjetur zgjidhje dhe për të mbajtur qëndrime mbi proceset, dukuritë, modelet dhe marrëdhëniet midis tyre, gjithashtu parashikon sfidat dhe ndërvarësitë rajonale botërore. Gjeografia e Shqipërisë ka për synim të studiojë natyrën, popullsinë dhe ekonomine e trevave shqipëtare, lidhjen e ndërsjellë ndërmjet natyrës dhe zhvillimit të organizimit hapësinor të veprimtarisë jetësore e prodhuese të shoqërisë si dhe studimin tërësor të rajoneve gjeografike shqipëtare.

Ekonomi 12

Në këto lende nxënësit njihen me veprimin e ligjit të kërkesës dhe ofertës në ekonominë e tregut dhe pajisen me mjetet e analizës që ata mund t'i përdorin edhe në linjat e tjera. Gjithashtu ata njihen e diskutojnë për parimet mbi të cilat bazohet vendimmarrja e firmave, financimi i tyre si dhe nivelet e konkurrencës së tregut. Ç'është ekonomia dhe faktorët e prodhimit, problemi ekonomik themelor dhe sistemet ekonomike, shtyllat e sipërmarrjes së lirë, skema e qarkullimit të aktivitetit ekonomik, kërkesa, oferta, ekuilibri i tregut, kontrolli i çmimeve nga forcat jo të tregut, konsumatori, burimet e të ardhurave dhe kursimi, buxheti vetjak, planifikimi i tij, sipërmarrësi, biznesi i vogël dhe roli ekonomik i tij, format e organizimit të biznesit, burimet financiar të biznesit, tregu i letrave me vlerë, kontabiliteti i biznesit. Prodhimi, kostoja, të ardhurat e firmës, konkurrenca e plotë, konkurrenca monopoliste, monopoli, oligopoli, tregu i punës, aspekte të tjera të tregut të punës, tregu i kapitalit dhe i tokës janë tematika të mundshme për t'u trajtuar në këtë lëndë.

Informatikë – TIK 10,11,12

Informatikë – TIK 10

Në klasën e dhjetë nxënësit mësojnë këta elementë: rrjetet kompjuterike, përpunimi digjital i të dhënave, HTML, CSS dhe Javascript. Këto njohuri të trajtuara përgjatë pjesës së parë të vitit mësimor pasurohen me elementë nga interneti. Në pjesën e dytë trajtohen algoritmika dhe gjuha e programimit C++ dhe JAVA.

Informatikë – TIK Bërthamë dhe i Avancuar 11

Në klasën e njëmbëdhjetë informatika ndahet në dy pjesë: Pjesa bërthamë dhe Pjesa me zgjedhje të detyruar. Në pjesën bërthamë trajtohen rrjetat kompjuterike dhe siguria ne rrjet, databaza dhe puna me Access, si dhe programimi në Python. Në informatikën me zgjedhje trajtohen këto elementë: Web Programming (HTML, CSS dhe Javascript) dhe programimi në C++ duke u përqëndruar tek matricat, stivat dhe radhët.

Informatikë – TIK 12

Në klasën e dymbëdhjetë thellohen njohuritë teknike ne TIK duke u përqëndruar në elementët: arkitekture kompjuteri, kompleksiteti i algoritmave, baza e të dhënave dhe SQL, kriptografia, enkriptimi dhe zhvillimi i aplikacioneve.

Vizatim Teknik / Autocad 10

Lënda e Vizatimit Teknik dhe AutoCAD-it jepet me metodat më sociale të përfytyrimit të formave të sendeve apo objekteve të ndryshme të natyrës. Vizatimi bëhet me ose pa vegla të vizatimit teknik, me dorë të lirë në formën e skicës, e cila shërben për bërjen e shpejtë të paraqitjes grafike të sendit apo objektit natyror. Nëse bëhet me vegla, ajo mer formën e vizatimit të punës. Në të dyja rastet, kemi të bëjmë me paraqitjen e objekteve të ndryshëm me përmasat e dhëna të gatshme për tu prodhuar ose e anasjellta, kur vizatimi është i bërë, nxënësi të jetë në gjendje ta lexojnë atë, për të krijuar idenë dhe përfytyrimin rreth objektit të paraqitur. Në AutoCAD nxënësit mësojnë kryesisht se si bëhet e mundur realizimi i vizatimit të objekteve të ndryshëm natyror nëpërmjet kompjuterit në 2D (në plan) dhe 3D (në hapësirë). Këto realizohen nëpërmjet mësimit të komandave kryesore të AutoCAD-it si dhe përfytyrimit të objekteve në hapësirë. Këto mbështeten tek praktika ku vazhdimisht bëhen ushtrime të ndryshme nga më të thjeshtat deri tek më të vështirat si nga pamjet deri tek vizatimet përmbledhëse etj.

Programe aplikative/principe dizenjimi

Materiali do te hidhet se shpejti...